



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 26
28.09.2015

NR. VENDIMI 21
29.09.2015

V E N D I M
“MBI SEKUESTRIMIN E PASURIVE”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përbërë prej :

GJYQTAR : DRITAN HALLUNAJ

me sekretare të seancës gjyqësore **Ankela DAKE**, mori në shqyrtim sot me **dt. 29.09.2015** në seancë kërkesën për sekuestrim me Nr. 26 Akti, të vitit 2015, që i përket:

KËRKUES: Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda - Tiranë, përfaqësuar nga prokurori **Armand Gurakuqi**.

OBJEKTI : Sekuestrim i pasurive.

KUNDËR:

- 1- Shtetasit **B. B.**, i biri i G. dhe i M., i dtl. xxxx, banues në xxxx.
- 2- Shtetases **M. B.**, e bija e S. dhe e A., e dtl. xxxx, banuese në xxxx.
- 3- Shtetasit **G. B.**, i biri i B. dhe i M., i dtl. xxxx.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.

Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën në tërësi;

Dëgjo përfaqësuesin e organit të akuzës, i cili përfundimisht kërkoi pranimin e kërkesës dhe konkretisht:

I. Sekuestrimin e pasurive të mëposhtme:

a) Në bankën xxxx Bank:

- 1- Llogaria e shtetasit G. B., në shumën **xxxx Euro;**
- 2- Llogaria në emër të shtetasit B. B., në vlerën **xxxx Euro;**
- 3- Llogaria në emër të shtetasit B. B., në vlerën **xxxx USD;**
- 4- Llogaria në emër të shtetasit B. B., në vlerën **xxxx USD;**
- 5- Llogaria në emër të shtetasit B. B., në vlerën **xxxx Euro;**
- 6- Depozitë në emër të shtetasit B. B., në vlerën **xxxx USD;**
- 7- Depozitë në emër të shtetasit B. B., në vlerën **xxxx Euro;**
- 8- Llogaria në emër të shtetases M. B., në shumën **xxxx lekë;**
- 9- Llogaria në emër të shtetases M. B., në vlerën **xxxx Euro;**
- 10- Llogaria në emër të shtetases M. B., në vlerën **xxxx Euro;**
- 11- Llogaria në emër të shtetases M. B., në vlerën **xxxx USD;**

- 12- Depozite në emër të shtetases M. B., në vlerën **xxxx Euro;**
- 13- Depozitë në emër të shtetases M. B., në vlerën **xxxx Euro;**
- 14- Depozitë llogarie në emër të shtetases M. B., në vlerën **xxxx Euro.**

b) Në bankën xxxx Bank:

1. Llogari në emër të shtetasit G. B., në lekë në gjëndje **xxxx lekë;**
2. Llogari në emër të shtetasit B. B., në valutë **xxxx Euro;**
3. Llogari në emër të shtetasit B. B., me gjëndje **xxxx lekë;**
4. Depozitë në emër të shtetasit B. B., në shumën **xxxx USD;**
5. Depozitë në emër të shtetasit B. B., në shumën **xxxx USD;**

II. Pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të sigurimit.

III. Për ekzekutimin e këtij vendimi, të ngarkohen Zyrat e Përmbarimit të Rrethit xxxx ndërsa për administrimin dhe përdorimin e pasurive, të ngarkohet Z. K. Xh., i cili është administrator në Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave, Tiranë.

V Ë R E N S E:

Pranë kësaj gjykate, ka paraqitur një kërkesë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për sekuestrimin e pasurive të shtetasve **B. B.**, i biri i G. dhe i M., i dtl. xxxx, banues në xxxx, **M. B.** dhe **G. B.**, sipas objektit të kërkuar, i cili është sipërcituar tek kërkitimi i prokurorit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, rezultoi se:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me datë xxxx, ka regjistruar **procedimin pasuror nr. xx**, në ngarkim të shtetasve **B. B.**, i biri i G. dhe i M., i dtl. xxxx, banues në xxxx dhe **M. B.**, e bija e S. dhe e A., e dtl. xxxx, banuese në xxxx

Ky procedim pasuror, është regjistruar mbi bazën e akteve të dërguara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me shkresën nr. xxxx Prot. datë xxxx, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, xxxx.

Në lidhje me faktin, objekt hetimit pasuror:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, xxxx, në datë xxxx ka regjistruar procedimin penal nr. xxxx, për kryerjen e veprave penale “Fshehja e të ardhurave” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga nenet 180 dhe 287 të K.Penal. Në datë xxxx, kjo Prokurori ka urdhëruar regjistrimin e emrave të shtetasve B. B. dhe M. B. si persona nën hetim për veprat penale të mësipërme.

Sipas akteve të dërguara prej Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, xxxx, rezulton se nga ana e shtetasit B. B., janë kryer transaksione në vlera të larta, me kompani të themeluara në vende të quajtura “xxxx”, konkretisht në xxxx, xxxx. Gjithashtu, në këto transaksione shtetasi B. B., ka përfshirë edhe familjarë të tij, si shtetasit M. B. dhe G. B.. Shumat e parave të qarkulluara pranë bankave shqiptare të nivelit të dytë, nuk përlligjen nga veprimtaritë e ligjshme të shtetasve të mësipërm.

Konstatohet se vlerat e përfituara, janë transferuar në llogari personale edhe pse shtetasi B. B. zotëron dy subjekte në emër të tij, aktiviteti i të cilave nuk justifikon natyrën e transaksioneve si dhe vlerave të larta që janë qarkulluar. Nga vlerësimi i fakteve objekt hetimi, konstatohen tentativa të vazhdueshme për kanalizimin e fondeve, nëpërmjet një kompanie të regjistruar konkretisht në xxxx, xxxx vend i njohur si xxxx.

Konkretisht shtetasi B. G. B., i datëlindjes xxxx, ka kryer veprimtari dhe transaksione në vlera të larta dhe të dyshimta, si vijon:

Nga verifikimi në QKR, rezulton që shtetasi B. B. të ketë regjistruar në emër të tij dy biznese:

- “**B. B.**” person fizik me NIPT xxxx, regjistruar në Janar 2011, me aktivitet “xxxx” me seli në xxxx.
- “**xxxx**” **shpk.** me NIPT xxxx, regjistruar në datë xxxxx, me aktivitet “xxxx”, me seli në xxxx.

Nga të dhënat, për periudhën 2010 - korrik 2012, ka transaksione në shuma të konsiderueshme, të qarkulluara kryesisht në llogarinë personale, por edhe në ato të shoqërive, pranë bankës. Konkretisht, në llogarinë personale, kreditimet gjatë muajve Janar-Mars 2012 janë **xxxx USD**.

Ndërsa, në llogaritë e shoqërive, transaksionet kanë qenë:

- “**B. B.**” **P.F.**: kreditime prej **xxxx USD**. Shumicën e transaksioneve (pagesat), B. B. i ka kryer nga Italia me kartë krediti, pasi ka deklaruar se jeton edhe në Itali.
- “**xxxx**” **shpk.**: kreditime për periudhën Prill-Qershor 2012, në shumën **xxxx USD dhe xxxx EUR**, ndërsa debitime në shumat xxxx USD dhe xxxx EUR.

Shtetasi B. B., operon si agjent reklamues (*blen dhe shet promociione/reklama nëpërmjet internetit*) dhe nga ky aktivitet kanë gjeneruar edhe fondet e mësipërme. Disa nga kompanitë me të cilat ka kryer transaksione janë: xxxx, xxxx, xxxx,xxxx,xxxx etj, të cilat po ashtu janë kompani që ofrojnë reklamimin online. Nga investigimi i kryer për periudhën vijuese:

Në emër të **B. B.** rezultoi se:

- Në llogaritë personale në USD:
 - Në datë xxxx, ka vendosur xxxx USD në depozitë.
 - Në datë xxxx, transferon xxxx USD tek xxxx.
 - Në xxxx, M. B. tërheq xxxx USD.
 - Në xxxx, M. B. derdh xxxx USD.
 - Në xxxx, ka përfituar në total xxxx USD nga xxxx.
 - Nga shoqëria “xxxx” (xxxx), ka përfituar në 2012 në total xxxx USD; në shtator – dhjetor 2013, në total xxxx USD, dhe në 2014, në total xxxx USD.
 - Në datë xxxx, M. B. ka derdhur xxxx USD.
 - Në datë xxxx, ka vendosur në depozitë me afat xxxx USD.
 - Në datë xxxx, transferon nga llogaria e shoqërisë xxxx shpk. në llogarinë personale xxxx USD (*po në nëntor 2014 ka mbyllur llogarinë e kësaj shoqërie në Bankë*).

Gjëndja në llogari xxxx USD dhe në depozitë në total xxxx USD.

- Në llogaritë personale në EURO:
- Në periudhën Maj 2012 - Shkurt 2013 i janë kaluar paga mujore nga shoqëria “**xxxx**” **shpk.** të barabartë me ekuivalentin në Lek (xxxx lek/muaj).

Gjithashtu ne vijimësi të hetimit, është konstatuar se ky shtetas, në datë xxxx, ka krijuar subjektin juridik “xxxx” me NIPT xxxx. Ky veprim është kryer ndërkohë që shoqëria “xxxx” shpk. është kaluar në procedurë likuidimi.

Mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, xxxx, nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, është vendosur sekuestro preventive mbi llogaritë bankare të shtetasve dhe të shoqërisë së mësipërme dhe kështu ndër të tjera, si më poshtë:

- Në bankën xxxx Bank:
 1. Llogaria e shtetasit G. B. (babai i shtetasit B.) llogaria në shumën **xxxx euro**,
 2. Për shtetasin B. B., llogari në vlerën **xxxx euro**, në vlerën **xxxx USD**, në vlerën **xxxx usd**, në vlerën **xxxx euro**, depozitë **xxxx USD**, depozitë **xxxx euro**.
 3. Llogaria e M. B., në shumën **xxxx leke**, **xxxx euro**, **xxxx euro**, **xxxx dollarë**, depozitë **xxxx euro**, depozitë **xxxx euro**, depozitë **xxxx euro**.
- Në bankën xxxx Bank:
 1. G. B., llogari në lekë, gjëndje **xxxx leke**, llogari në valutë **xxx euro**,
 2. B. B., llogari me gjëndje **xxxx leke**, depozitë në shumën **xxxx USD**, depozitë në shumën **xxxx USD**.

Shtetasi B. B., ashtu siç është parashtruar më lart, në datën xxxx, ka krijuar subjektin juridik “xxxx” me NIPT xxxx dhe këtë subjekt e ka krijuar pas kalimit të subjektit “xxxx” likuidim dhe pasi ka pasur probleme në një bankë të nivelit të dytë, për të kryer veprime pasi i është kërkuar dokumentacion justifikues. Më konkretisht B. G. B., ka paraqitur në janar 2014, pranë një banke të nivelit të dytë, kërkesë për çelje llogarie në emër të shoqërisë “xxxx”, e themeluar në Tortola, British Virgin Islands. Shtetasi B. është prezantuar si pronar i kësaj shoqërie, ndërkohë që sipas dokumentacionit përkatës, si pronare e vetme rezulton të jetë individi Sh. S. Th. V. Kerkhove. Në këto kushte banka ka refuzuar të ofrojë shërbimin e

kërkuar nga shtetasi B..

Drejtoria Rajonale Tatimore, xxxx, me shkresën xxxx, dt.xxxx, ka dërguar informacion dhe aktet përkatëse lidhur me rezultatet financiare për vitet 2012, 2013, 2014, për subjektet objekt hetimi pasuror. Nga kjo shkresë dhe aktet bashkëlidhur rezultojn sa vijon:

1. Shoqëria “xxxx” sh.p.k. (themeluar në mars të vitit 2012), për vitin 2012 ka përfunduar me fitim në vlerën xxxx lekë; për vitin 2013 me humbje xxxx lekë; dhe vitin 2014 me humbje në vlerën xxxx lekë. Kjo shoqëri, siç është trajtuar më lart, është në proces likuidimi.
2. Subjekti “B. B.” për vitin 2012 ka pasur fitim në shumën xxxx lekë ndërsa për vitin 2013 ka deklaruar fitim zero.

Nga informacioni i ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore xxxx, ndër të tjera, ka rezultuar se ndaj subjektit “xxxx” sh.p.k. është ushtruar kontroll sipas njoftimit kontrollit të datës xxxx dhe program kontrollit të po kësaj date. Raport kontrolli është përpiluar në datë xxxx dhe nga ky raport kontrolli, ka rezultuar se shoqëria bën reklama por nuk ka paraqitur fatura nga subjektet për të cilët ka bërë këto reklama nëpërmjet internetit. Subjekti ka tërhequr blloqe faturash tatime, të cilat nuk i ka përdorur. Për mosmbajtje të rregullt të dokumentacionit, ky subjekt është dënuar me gjobë në shumën xxxx lekë për vitin 2012, 2013. Organi tatimor është mjaftuar me deklarin e bërë në lidhje me mënyrën e aktivitetit nga shoqëria “xxxx” sh.p.k. dhe kjo shoqëri nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion justifikues dhe as ndonjë kontratë për këto shërbime.

Në llogarinë e subjektit “xxxx” sh.p.k. ka kreditime të shumta. Këto kreditime në llogarinë e shoqërisë “xxxx” sh.p.k. kanë ardhur nga jashtë dhe nuk kanë përshkrime dhe dokumente justifikues mbi origjinën dhe burimin e parave. Shtetasit B. dhe M. B., kanë qarkulluar vlera shumë të larta parash, të cilat nuk justifikohen nga fitimet e deklaruara pranë organeve tatimore. Gjithashtu subjekti B., ka dashur të hapë llogari bankare, veprime në një bankë të nivelit të dytë, për shoqërinë xxxx, e themeluar në Tortola, British Virgin Islands, pa qenë pronar apo administrator i saj. Pasi nga banka e nivelit të dytë është konstatuar se shtetasi B. nuk ishte administrator i shoqërisë, është refuzuar ky veprim.

Në kushtet e mësipërme, organi i akuzës, ka ngritur dyshimin e arsyeshëm i mbështetur në prova, se shtetasit B. B. dhe M. B., kanë kryer veprat penale “Fshehja e të ardhurave” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga nenet 180 dhe 287 të Kodit Penal. Vepra penale e parashikuar nga neni 287, bën pjesë në kategorinë e atyre të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit nr. 10192

datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive”.

Në të njëjtën kohë shtetasit B. B., M. B. dhe G. B., përfshihen në rrethin e subjekteve ndaj të cilëve zbatohen masat e parashikuara nga ligji nr. 10192 datë 03.12.2009.

Nga hetimet e deritanishme, rezulton se pasuria e mësipërme, është krijuar pas periudhës së aktivitetit të dyshuar kriminal dhe pas vitit 2010, viti i hyrjes në fuqi dhe shtrirjes së efekteve të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, dhe si rrjedhim ky ligj zbatohet për këtë pasuri. Në rastin objekt hetimi pasuror, ekziston një rrezik real dhe potencial, që pasuria e shtetasve B.B., M. B. dhe G. B., të tjetërsohet dhe të humbasë.

Për sa më sipër, në bazë të neneve 3/1/d, 3/2/a, 3/4 deri ne 7, 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, përfaqësuesi i akuzës, kërkoi sekuestrimin e pasurive në emër të shtetasve B. B., M. B. dhe G. B., konkretisht: 1. Në bankën xxxx Bank: Llogaria e shtetasit G. B., në shumën xxxx Euro; Llogaria në emër të shtetasit B. B., në vlerën xxxx Euro; Llogaria në emër të shtetasit B. B., në vlerën xxxx USD; Llogaria në emër të shtetasit B. B., në vlerën xxxx USD; Llogaria në emër të shtetasit B. B., në vlerën xxxx Euro; Depozitë në emër të shtetasit B. B., në vlerën xxxx USD; Depozitë në emër të shtetasit B. B., në vlerën xxxx Euro; Llogaria në emër të shtetasës M. B., në shumën xxxx lekë; Llogaria në emër të shtetasës M. B., në vlerën xxxx Euro; Llogaria në emër të shtetasës M. B., në vlerën xxxx Euro; Llogaria në emër të shtetasës M. B., në vlerën xxxx USD; Depozite në emër të shtetasës M. B., në vlerën xxxx Euro; Depozitë në emër të shtetasës M. B., në vlerën xxxx Euro; Depozitë llogarie në emër të shtetasës M. B., në vlerën xxxx Euro. 2. Në bankën xxxxx Bank: Llogari në emër të shtetasit G. B., në lekë në gjëndje xxxx lekë; Llogari në emër të shtetasit B. B., në valutë xxx Euro; Llogari në emër të shtetasit B. B., me gjëndje xxxx lekë; Depozitë në emër të shtetasit B. B., në shumën xxxx USD; Depozitë në emër të shtetasit B. B., në shumën xxxx USD, pasi plotësohen kriteret e parashikuara nga ky ligj, për sekuestrimin e këtyre llogarive.

Këtë kërkesë për sekuestrim, prokurori e bazoi edhe në provat të cilat u administruan në dosje, konkretisht:

- Vendim për regjistrimin e procedimit pasuror dt. xxxx.
- Relacion për kalimin e akteve Seksionit të Hetimit Pasuror.

- Urdhri i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, xxxx, i datës xxxx, për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga nenet 287 dhe 180 të Kodit Penal.
- Urdhër i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, xxxx, i datës dt. xxxx, për regjistrimin e emrit të shtetasve B. B. dhe M. B. në regjistrin e veprave penale.
- Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë xxxx, nr. xxxx, dt. xxxx, për vendosjen e sekuestros preventive.
- Procesverbal këqyrje-marrje të dokumentave, dt. xxxx, lidhur me subjektet e regjistruara në emër të shtetasve B. B. dhe M. B..
- Shkresë nr.xxxx Prot. dt. xxxx, e bankës xxxx Bank, si dhe aktet bashkëlidhur.
- Shkresë nr.xxxx, dt.xxxx e bankës xxxx Bank.
- Shkresa nr. xxxx, dt. xxxx dhe nr. xxxx, dt. xxxx, të bankës xxxx, si dhe aktet bashkëlidhur.
- Shkresa kthim përgjigje nga bankat e nivelit të dytë që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Shkresë xxxx Prot. dt. xxxxx, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, xxxx, si dhe aktet bashkëlidhur.
- Shkresë xxxx Prot. dt. xxxx, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, xxxx, si dhe aktet bashkëlidhur.
- Shkresë xxxx Prot. dt. xxxx, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, xxxx, si dhe aktet bashkëlidhur.
- Raporte kontrolli të pasurisë, i datës xxxx, xxxx, të Drejtorisë Rajonale Tatimore, xxxx, si dhe akte konstatimi të kësaj drejtorie.
- Shkresë nr. xxxx Prot. datë xxxx e Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor, xxxx, si dhe aktet bashkëlidhur.
- Shkresa kthim përgjigje nga Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme që ndodhen në Republikën e Shqipërisë.
- Procesverbale transkriptimi të përgjimit të komunikimeve telefonike, të realizuara nga Sektori i Përgjimit të Telekomunikacioneve dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative, në Prokurorinë e Përgjithshme.
- Gjëndja familjare të shtetasve B. B. dhe M. B., e datës xxxx
- Si dhe të gjitha aktet e tjera bashkëngjitur kërkesës.

Gjykata, në këto kushte, pasi dëgjoji përfaqësuesin e akuzës, si dhe pasi administroi provat shkresore në dosje, çmon se kërkesa e Prokurorisë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për sekuestrimin e pasurive të

përmendura më sipër, konkretisht: 1. Në bankën xxxx Bank: Llogaria e shtetasit G. B., në shumën xxxx Euro; Llogaria në emër të shtetasit B. B., në vlerë xxxx Euro; Llogaria në emër të shtetasit B. B., në vlerën xxxx USD; Llogaria në emër të shtetasit B. B., në vlerën xxxx USD; Llogaria në emër të shtetasit B. B., në vlerën xxxx Euro; Depozitë në emër të shtetasit B.B., në vlerën xxxx USD; Depozitë në emër të shtetasit B. B., në vlerën xxxx Euro; Llogaria në emër të shtetasës M. B., në shumën xxxx lekë; Llogaria në emër të shtetasës M. B., në vlerën xxxx Euro; Llogaria në emër të shtetasës M. B., në vlerën xxxx Euro; Llogaria në emër të shtetasës M. B., në vlerën xxxx USD; Depozite në emër të shtetasës M. B., në vlerën xxxx Euro; Depozitë në emër të shtetasës M. B., në vlerën xxxx Euro; Depozitë llogarie në emër të shtetasës M. B., në vlerën xxxx Euro. 2. Në bankën xxxx Bank: Llogari në emër të shtetasit G. B., në lekë në gjëndje xxxx lekë; Llogari në emër të shtetasit B. B., në valutë xxxx Euro; Llogari në emër të shtetasit B. B., me gjëndje xxxx lekë; Depozitë në emër të shtetasit B. B., në shumën xxxx USD; Depozitë në emër të shtetasit B. B., në shumën xxxx USD, duhet të pranohet, pasi plotësohen kriteret e Ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë”.

Sipas **nenit 3/1, pika d)**, si dhe po **nenit 3/2, pika a)**, të **ligjit nr.10192, datë 03.12.2009**, në të cilin përcaktohet fusha e zbatimit të këtij ligji, konstatohet se pasuritë e e mësipërme të shtetasve B. B., M. B., si dhe G. B., janë objekt i zbatimit të këtij ligji.

Në rastin konkret, sipas provave të administruara në gjykim, ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në indicie që tregon se shtetasi B. B., i biri i G. dhe i M., i dtl. xxxx, banues në xxxx, si dhe shtetasja M. B., e bija e S. dhe e A., e dtl. xxxx, banuese në xxxx, janë të përfshirë në veprimtarinë kriminale dhe se ekziston dyshimi për kryerjen nga ata të veprave penale të “Fshehja e të ardhurave” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga nenet 180 dhe 287 të K.Penal.

Gjithashtu ekziston dyshimi që familjarët e tyre, në rastin konkret shtetasi G. B., i biri i B. dhe i M., i dtl. xxxx, të zotërojë pasuri të paligjshme për shkak dhe në lidhje me veprimtarinë e tyre kriminale.

Duke patur parasysh ligjin nr.10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë”, përkatësisht **nenin 3 pika 2** të tij, dispozitat e këtij ligji do të zbatohen edhe ndaj pasurive të personave të afërm të subjektit mbi të cilin ekziston

dyshimi i arsyeshëm, pasuritë e të cilit i nënshtrohen zbatimit të këtij ligji, dhe konkretisht tek babai i shtetasit të dyshuar B. B., njëkohësisht edhe bashkëshorti i shtetases së dyshuar M. B., shtetasi G. B..

Sipas **nenit 11 i këtij ligji**, në referencë të nenit 3 të tij, ku shprehet për kriteret e sekuestrimit të pasurisë, si dhe mbi bazën e provave të paraqitura nga prokurori, dhe të administruara në dosje, gjykata çmon se duhet të merren masat parandaluese pasurore, për sekuestrimin e pasurive të sipërcituara, pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në indicie, që tregojnë se personat e mësipërm, mund të jetë përfshirë në veprimtari kriminale, dhe zotërojnë pasuri apo të ardhura që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme. Në rastin objekt hetimi pasuror, ekziston rrezik real, që pasuria e shtetasve B. B., M. B. dhe G. B., të tjetërsohet dhe të humbasë.

Gjykata, për efekt të vendimit të sekuestrimit të pasurive të përmendura në këtë vendim, vendosi që të pranojë kërkesën e prokurorit, për pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të sigurimit.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 3, 7, 11, 12, 14 dhe 15 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë”

V E N D O S I:

- **Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.**
- **Sekuestrimin e pasurive të shtetasve:**
 - 1- Shtetasit B. B., i biri i G.dhe i M., i dtl. xxxx, banues në xxxx.
 - 2- Shtetases M. B., e bija e S. dhe e A., e dtl. xxxx, banuese në xxxx.
 - 3- Shtetasit G. B., i biri i B. dhe i M., i dtl. xxxx.
- **Konkretisht, sekuestrimin e pasurive të mëposhtme:**
 - a) **Në bankën xxxx Bank:**
 1. Llogaria e shtetasit G. B., në shumën **xxxx Euro;**
 1. Llogaria në emër të shtetasit B. B., në vlerën **xxxx Euro;**
 1. Llogaria në emër të shtetasit B. B., në vlerën **xxxx USD;**
 1. Llogaria në emër të shtetasit B. B., në vlerën **xxxx USD;**

1. Llogaria në emër të shtetasit B. B., në vlerën **xxxx Euro**;
1. Depozitë në emër të shtetasit B. B., në vlerën **xxxx USD**;
1. Depozitë në emër të shtetasit B. B., në vlerën **xxxx Euro**;
1. Llogaria në emër të shtetasës M. B., në shumën **xxxx lekë**;
1. Llogaria në emër të shtetasës M. B., në vlerën **xxxx Euro**;
1. Llogaria në emër të shtetasës M. B., në vlerën **xxxx Euro**;
1. Llogaria në emër të shtetasës M. B., në vlerën **xxxx USD**;

1. Depozite në emër të shtetasës M. B., në vlerën **xxxx Euro**;
1. Depozitë në emër të shtetasës M. B., në vlerën **xxxx Euro**;
1. Depozitë llogarie në emër të shtetasës M. B., në vlerën **xxxx Euro**.

b) Në bankën xxxx Bank:

1. Llogari në emër të shtetasit G. B., në lekë në gjëndje **xxxx lekë**;
1. Llogari në emër të shtetasit B. B., në valutë **xxxx Euro**;
1. Llogari në emër të shtetasit B. B., me gjëndje **xxxx lekë**;
1. Depozitë në emër të shtetasit B. B., në shumën **xxxx USD**;
1. Depozitë në emër të shtetasit B. B., në shumën **xxxx USD**;

- Pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të sigurimit.
- Për ekzekutimin e këtij vendimi, të ngarkohen Zyrat e Përmbartimit të Rrethit xxxx, ndërsa për Administrimin dhe përdorimin e kësaj pasurie, të ngarkohet **Z. K. Xh.**, i cili është Administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda afatit ligjor në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë.
- Për palët e interesuara, afati i ankimit fillon nga momenti i marrjes dijeni.
- **U shpall në Tiranë, me dt. 29.09.2015.**

SEKRETARE

GJYQTAR

ANKELA DAKE

DRITAN HALLUNAJ

